



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI



NDËRMARRJA
HIDROEKONOMIKE
"IBËR LEPENCI" SH.A



01-102
DI 16.01.2019
PRISHTINË - PRIŠTINA

AGJENCIA KADASTRALE
E KOSOVËS

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA	
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS-KOŠOVSKA KATASTRARSKA AGENCIJA	
Nr./Br.	01/39/19
Nr.i fq./Br.str.	
Data/Datum:	11-1-2019
PRISHTINË-PRIŠTINA	

I lidhur në mes të:

1. Agjencia Kadastrale e Kosovës, me seli në Prishtinë, Adresa: Rr. "Çlirimi", Nr: 25, Ndërtesa e Arkivit / Kati II, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës; dhe
2. Ndërmarrja Hidroekonomike "IbërLepenci" SH.A me selinë qendrore në Prishtinë, Adresa: Sheshi "BillClinton" nr.13 - 10000, Prishtinë - Republika e Kosovës

Neni 1 Qëllimi

Ky memorandum i bashkëpunimit ka për qëllim të ofrimit të ndihmës teknike, praktikës këshillëdhënëse në fushën e gjeodezisë, kadastrit dhe pronës si dhe ofrimit të dhënave gjeohapësinore nga ana e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e këtij memorandumi të bashkëpunimit janë në harmoni me kapacitetet profesionale dhe ndërinstitucionale dhe si i tillë është i obligueshëm që Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Ndërmarrja N.H "Ibër Lepenci" SH.A. në mënyrë të vullnetshme dhe profesionale t'i zbatojnë pikat e memorandumit me vullnet të lirë të palëve të lartshënuara. Të asistohet tek N.H "Ibër Lepenci" SH. A në fushëveprimtarinë e lartshënuar nga ana e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Neni 3 Obligimet

Obligimet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe N.H "IbërLepenci" SH.A.

Komisioni i N.H. "Ibër Lepenci" SH.A ofron të gjithë dokumentacionin e përkatës dhe është në dispozicion me tërë kapacitetet e veta në shërbim të nevojës imediate të N.H. "Ibër Lepenci" SH.A për të definuar infrastrukturën e N.H "Ibër Lepenci" SH.A e cila është e nevojshme për shkak të situatës dhe rëndësisë së veçantë që ka N.H. "Ibër Lepenci" SH.A. dhe në anën tjetër për shkak të gjendjes jo të mirë në kuptim të evidentimit dhe verifikimit pronës, ndërsa Agjencia Kadastrale e Kosovës zotohet se i del në ndihmë në rrafshin profesional me të gjitha kapacitetet që i nevojiten në çështjet e pronës, gjeodezisë dhe kadastrit.

Neni 4

Ndryshimi i memorandumit

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij memorandumit mund të bëhen në të ardhmen me pajtimin e të dy palëve.

Neni 5

Komisionet

Për realizimin e obligimeve nga ky momerandum palën nëshkruese formojnë Komisionet si në vijim:

Përfaqësues të ndërmarrjes N.H "Ibër Lepenc" SH.A. të emëruar nga Kryeshefi Ekzekutiv z.Berat Lushtaku në këtë aktivitet janë : z. Fadil Shehu - kryetar, z. Demë Abazi- anëtar dhe z. Ernest Kërçeli - anëtar.

Përfaqësues të Agjencisë Kadastrale të Kosovës të emëruar nga U.D. Kryeshefi Ekzekutiv, z. Avni Ahmeti në këtë aktivitet janë: Faik Kelmendi-kryetar, Naim Nishori -anëtar, Ajshe Gashi -anëtar.

Neni 6

Konfidencialiteti

Palët bien dakord të ruajnë konfidencialitetin e çdo informacioni ose materiali të siguruar nga njëra palë për palën tjetër si dhe të çdo informacioni të njohur nga njëra palë për shkak të shoqërimit të saj me palën tjetër në pajtim me këtë Memorandum Mirëkuptimi që nuk kanë qenë bërë publike, si dhe akoma më tej ata bien dakord se nuk do të bëjnë të njohur një informacion ose material të tillë për një palë te tretë pa autorizimin paraprak të palës tjetër.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast të mos marrëveshjeve eventuale palët e nënshkrimit të këtij Memorandumi të bashkëpunimit kontestet i zgjidhin në mes vete.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit!

Për: NH "IbërLepenc"

Berat Lushtaku

Kryeshefi Ekzekutiv





Për: AgjencinëKadastrale të Kosovës

Avni Ahmeti

UD. Kryeshef Ekzekutiv



